



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ
UNIVERSITY OF APPLIED SCIENCES IN FERIZAJ

Njësia Org.

Org. Unit

Nr. i faqeve

No. pages

Nr. Prot.

Prot. No.

Data:

Data:

5680/25

22.12.25

Datë: 22.12.2025

Në bazë të nenit 16, të Ligjit të Punës nr.03/L-212 dhe vendimit të Këshillit Drejtues të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), nr. 3189/25, të datës 24.09.2025, Administrata Qendrore e UShAF, me datën 22.12.2025, shpallë:

KONKURS

PËR ANGAZHIMIN E STUDENTËVE DHE TË DIPLOMUARVE NË PUNË PRAKTIKE NË ADMINISTRATËN QENDRORE TË UShAF.

I. Titulli i vendit të punës: Praktikantë, 4 (katër) pozita në Administratën Qendrore të UShAF

- 2 (dy) studentë të diplomuar në UShAF në studimet bachelor ose master;
- 1 (një) student i rregullt (viti i tretë ose absolvent) në studimet bachelor ose (viti i dytë ose absolvent) në studimet master në UShAF;
- 1 (një) student i rregullt (viti i tretë ose absolvent) në studimet bachelor, programi i studimit: Informatikë e Aplikuar.

1. Një praktikant në zyrën e shërbimit të studentëve;
2. Një praktikant në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm;
3. Një praktikant për ndihmë administrative në njësitë akademike të UShAF;
4. Një praktikant në zyrën e Teknologjisë Informative (kërkohej të jetë student i rregullt në vitin tretë ose absolvent në programin e studimit: Informatikë e Aplikuar, niveli bachelor).

Periudha e angazhimit në punë praktike është për 6 (gjashtë) muaj me pagesë (350 euro bruto në muaj).

Kriteret për përzgjedhjen e studentëve për punë praktike:

- Kandidatët për punë praktike duhet të kenë përfunduar studimet bachelor ose master në UShAF për pozitën: „**2 (dy) studentë të diplomuar në UShAF në studimet bachelor ose master**”;
- Kandidatët për punë praktike duhet të jenë studentë aktual të rregullt (viti i tretë ose absolvent) në studimet bachelor ose (viti i dytë ose absolvent) master në UShAF për pozitën: „**1 (një) student i rregullt (viti i tretë ose absolvent) në studimet bachelor ose (viti i dytë ose absolvent) master në UShAF**”.

- Kandidatët për punë praktike duhet të jenë studentë aktual të rregullt (viti i tretë ose absolvent në programin e studimit: Informatikë e Aplikuar, niveli bachelor) për pozitën:

1 (një) student i rregullt (viti i tretë ose absolvent) në studimet bachelor, programi i studimit: Informatikë e Aplikuar.

- Në përzgjedhjen e studentëve për punë praktike, do të merret parasysh nota mesatare gjatë studimeve e cila do të jetë përcaktuese në rangimin e kandidatëve.
Në rast se dy kandidatë ose më shumë, të renditur të fundit në pozita sipas notës mesatare, kanë notën mesatare të njëjtë, atëherë përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore. Nëse kandidatët janë të gjinisë së njëjtë (femërore) atëherë përzgjedhja do të bëhet me short në prezencë të kandidatëve.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

Kandidatët me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:

- Aplikacionin i cili merret në Administratën e UShAF, Zyra nr. 008;
- CV;
- Çertifikatën e lindjes (origjinale) ose ekstraktin e lindjes (origjinal) pranohet edhe dokumenti i printuar nga platforma E-Kosova;
- Çertifikatën e diplomës ose diplomën për kryerjen e studimeve bachelor ose master, origjinale apo të noterizuar (kandidatët që janë të diplomuar, të cilët konkurojnë për pozitën nr. 1).
- Çertifikatën e notave origjinale;
- Vërtetimin e statusit të studentit origjinal (studentët aktual apo absolventët)

Aplikacionet e plotësuara së bashku me dokumentacionin e nevojshëm sipas konkursit, duhet të dorëzohen në formë fizike në zyrën nr. 008 dhe në adresën elektronike në e-mail: info@ushaf.net.

Konkursi mbetet i hapur tetë (8) ditë, përkatësisht nga data **22.12.2025** deri me datën **29.12.2025** në orën 16:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë me konkurs nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Shpallja e listës me kandidatët e përzgjedhur dhe jo të përzgjedhur nga komisioni profesional do të bëhet në Web faqen e Universitetit.

Studentët do të jenë të angazhuar me orar të plotë (08:00-16:00) sipas legjislacionit në fuqi.

Kandidatët të cilët nuk pranohen kanë të drejtë ankese në afat prej 24 orëve nga koha e shpalljes së rezultateve, në Komisionin për shqyrtimin e ankesave në kuadër të UShAF.

Ferizaj, 22.12.2025

ADMINISTRATA QENDRORE E UShAF

